

VENDIM
Nr.197, datë 16.3.2011

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR KFOR, KOSOVË

(Ndryshuar me VKM nr. 172, datë 6.3.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen në operacionin ushtarak ndërkombëtar KFOR, Kosovë, të 5 (pesë) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Misioni është planizimi, monitorimi, komandimi dhe kontrolli i aktivitetit operacional të seksioneve dhe njësive të KFOR-it.

3. Kohëzgjatja e misionit është deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj, *së cilës i shtohet edhe periudha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës me vendndisim në Prishtinë, Kosovë.*

4. Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Tiranë-Prishtinë dhe anasjelltas është përgjegjësi e palës shqiptare.

5. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet, si më poshtë vijon, për:

a) shpërbimin që do të marrin këta ushtarakë për vështirësi shërbimi, në masën 4000 (katër mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) siguracion jete;

c) akomodim;

ç) ushqim;

d) lavanteri;

dh) shpenzime ndërlidhjeje emergjente;

e) trajtim mjekësor;

ë) mbështetje shëndetësore;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit;

g) *shpenzime për zhvillimin e aktiviteteve social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit.*

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha